LIGJ
Nr. 8584, datë 15.3.2000

PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË LIGJIN NR.8339, DATË 30.4.1998, "PËR KRIJIMIN E AGJENCISË SË TRAJTIMIT TË KREDIVE"

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI

I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
VENDOSI:

Në ligjin nr.8339, datë 30.4.1998 "Për krijimin e Agjencisë së Trajtimit të Kredive" bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

Neni 1

Në nenin 2, në fjalinë e parë, fjalët "… person juridik shtetëror…" zëvendësohen me fjalët "… person juridik publik, me vetëfinancim…".

Neni 2

Në nenin 3, pas shkronjës "b" shtohet shkronja "c" me këtë përmbajtje:
"Në rastet e përfundimit të procesit të privatizimit të një banke tregtare të nivelit të dytë, me kapital tërësisht shtetëror, me urdhër të ministrit të Financave, Agjencia trajton të gjitha detyrimet që rrjedhin nga kreditë e dhëna nga banka përkatëse, pavarësisht nga burimi i kredisë."

Neni 3

Në nenin 4, pas paragrafit të fundit, shtohet një paragraf me këtë përmbajtje:
"Në rastin e privatizimit të bankave tregtare të nivelit të dytë, me kapital tërësisht shtetëror, Agjencia merr në dorëzim praktikat e kredive, si dhe tepricat e llogarive për secilën prej tyre, sipas gjendjes së pasqyruar në bilancin e paraqitur për privatizimin e bankës përkatëse."

Neni 4

Në nenin 5 shtohet një paragraf me këtë përmbajtje:
"Kreditë e pakthyera tej afateve të përcaktuara në marrëveshjet përkatëse vlerësohen si tituj ekzekutivë."

Neni 5

Në nenin 11, pas fjalëve "… të shkronjës "b"" shtohen fjalët "dhe "c"…"

Neni 6

Në nenin 21, pika 3 ndryshohet si vijon:
"Me propozimin e Drejtorit të Përgjithshëm miraton kushtet e përgjithshme të marrjes në punë, sipas kërkesave të ligjit "Për statusin e nëpunësit civil", pagën, strukturën dhe numrin e personelit të Agjencisë."

Neni 7

Në nenin 24, dy fjalitë e fundit të paragrafit të parë, shfuqizohen.

Neni 8

Në nenin 25, në rreshtin e parë, fjalët “si person juridik shtetëror”, zëvendësohen me fjalët “si person juridik publik me vetëfinancim.”

Neni 9

Pas nenit 28, shtohet neni 28/a me këtë përmbajtje:

“1. Buxheti i Agjencisë miratohet nga ministri i Financave brenda muajit janar të çdo viti.

2. Të ardhurat që realizon Agjencia gjatë ushtrimit të veprimtarisë së saj derdhen në buxhetin e shtetit, përveç atyre që parashikohen në pikën 3 të këtij neni dhe atyre që detyrohet t'i kthejë bankave tregtare të nivelit të dytë me kapital tërësisht shtetëror, në rastin kur Agjencia kryen rolin e agjentit.

3. Nga të ardhurat që realizon Agjencia gjatë ushtrimit të veprimtarisë, ajo ka të drejtë të përdorë për të përballuar nevojat e saj, këto fonde:

a) 20 për qind të arkëtimeve që rrjedhin nga shlyerja e kredive;

b) komisioni prej 1.5 për qind në vit mbi pasivet që i detyrohen palëve të huaja;

c) interesat e arkëtuar prej fondeve të veta, të depozituara në bankat tregtare të nivelit të dytë. Agjencia bën depozitimin e shumave, sipas kësaj pike, pasi të ketë marrë me shkrim të paktën 3 (tri) oferta nga bankat tregtare të nivelit të dytë, që ushtrojnë veprimtarinë e tyre në Republikën e Shqipërisë;

ç) komisionet e përcaktuara në marrëveshje me bankat tregtare të nivelit të dytë me kapital tërësisht shtetëror, kur Agjencia vepron si agjente e bankave, sipas parashikimeve të këtij ligji;

d) të ardhura të tjera.

Neni 10

Në nenin 29, paragrafi i parë ndryshohet si vijon:

“Paga e Drejtorit të Përgjithshëm të Agjencisë përcaktohet me vendim të Këshillit të Ministrave.”

Neni 11

Në nenin 31, në paragrafin e dytë, në rreshtin e katërt, pas fjalëve “… të shkronjës “b” shtohen fjalët “dhe “c” …”

Neni 12

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr.2577, datë 27.3.2000 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Rexhep Meidani.